

Data 26.06.2024

KALLËZIM PENAL

- KALLËZUES:** Organizata “Shqipëria bëhet” e regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. 7173 vendimi të vitit 2023, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Adriatik Lapaj i biri i Ferman-it dhe Floridës, i datëlindjes 09.06.1988, lindur në Sarandë dhe banues në Tiranë me nr. personal identiteti I80609129K.
- TË KALLËZUAR:** Ilir Beqja;
Ogerta Manastirliu;
Albana Kociu
Enkelejdi Joti
Albana Fico
Shtetasit që rezultojnë nga hetimi se kanë konsumuar vepra penale.
- DREJTUAR:** Përpara Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
- OBJEKTI:** Kallëzim i veprës penale të "Shpërdorimit të Detyrës" "Vrasje me dashje", "Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër" "Neglizhenca në trajtimin mjekësor" të kryera në bashkëpunim të parashikuara nga neni 76, 77, 96, 248 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.
- BAZA LIGJORE:** Nent 22, 23, 25, 26, 76, 96, 248 të Kodit Penal;
Nenet 280, 283 të K.Pr.Penale;
Ligji nr.10 107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”;
Pikat 1, 2, 3 dhe 4/a, të VKM nr. 135, datë 20.2.2013, “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime”, i ndryshuar,
Neni 5, pika 2, gjerat “a” dhe “b”, nenin, 10, pika 1, gjerat “a”, “b”, dhe “c”, nenin 12, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 10 383, dt. 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
Pika 1, e VKM nr. 307, dt. 21.05.2014, “Për regjistrimin dhe identifikimin e personave të siguruar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor”, i ndryshuar;
Neni 50, i Ligjit nr. 9106, dt. 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 1, neni 2/1 dhe neni 3, gjerat “a” dhe “ç”.

DREJTUAR PROKURORISË SË POSACME
KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

I nderuar Z. Prokuror,

Bazuar në nenet 280 dhe 283 të Kodit të Procedurës Penale parashtrojmë këtë kallëzim penal për veprat penale të sipërcituara, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

I. RRETHANAT E FAKTEVE

1.1 Me shkresën me Nr. 9/1 prot, datë 12.01.2024 (administruar në QSU “Nënë Tereza” me nr. 257/1 prot, datë 18.01.2024) Organizata “Shqipëria bëhet” i ka kërkuar Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë informacion për sa më poshtë:

1. Cila ka qënë sasia e nevojshme në pavionet e QSUT për vitet 2020,2021,2022, 2023 për barnat:
 - a) Metratroxate 50mg;
 - b) L-Asparaginase;
 - c) Mabetheria;
 - d) Velcade;
 - e) Neupogen;
 - f) Endoksan;
 - g) Dacarbasin

2. Cila ka qënë sasia e tenderuar për vitet 2020,2021 ,2022 dhe 2023 për barnat:
 - a) Metratroxate 50mg;
 - b) L-Asparaginase;
 - c) Mabetheria;
 - d) Velcade;
 - e) Neupogen;
 - f) Endoksan;
 - g) Dacarbasin

3. Cila ka qënë sasia e administruar pranë QSUT dhe në pavionet e QSUT për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023 për barnat:
 - a) Metratroxate 50mg;
 - b) L-Asparaginase;
 - c) Mabetheria;
 - d) Velcade;
 - e) Neupogen;
 - f) Endoksan;

g) Dacarbasin

Me shkresën me Nr. 257/14 Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë ka kthyer përgjigje sa më poshtë:

h) Dacarbasin

Nr.	Emertimi i pergjithshem	Marreveshje kuader 2020-2022 24 muaj (sasia ne flakon)	Marreveshje kuader 2022-2024 24 muaj (sasia ne flakon)	Konsum 2020 (sasia ne flakon)	Konsum 2021 (sasia ne flakon)	Konsum 2022 (sasia ne flakon)	Konsum 2023 (sasia ne flakon)
1	Methotrexate 50 mg	9000	3600	230	0	333	73
2	L-aspariginase	0	0	256	52	0	0
3	Rituximab 100 m	670	1100	300	431	271	427
4	Rituximab 500 m	1450	2000	860	883	552	920
5	Bortezomib 3.5 m	2000	2000	1017	1522	1435	1493
6	Filgastrim	10300	11000	3426	5436	4622	5979
7	Cyclophosphamide	14000	19000	6108	8187	7529	6805
8	Dacarbasine	5500	5500	3216	2662	1894	1760

Për sa me sipër po ju vendosim në dispozicion informacionin e kërkuar si më poshtë vijon:

Kemi patur gjendje nga kontrata e një viti më parë. **Aspariganasa nuk ka patur import që prej vitit 2017, por QSUT ka trajtuar pacientet me bar alternativ.**

2.1 Me shkresën me Nr. 257/17 Prot QSUT, datë 07.05.2024 Organizata "Shqipëria bëhet" i ka kërkuar Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë informacion për sa më poshtë:

Në kuadër të punës së kësaj Lëvizje si edhe bazuar në parashikimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Neni 23, sipas të cilit na lind e drejta e informimit për veprimtarinë e organeve shtetërore, në këtë rast e drejta për tu informuar **plotësisht dhe saktësisht** sic kemi kërkuar në shkresën e mëparshme me Nr. 9/1 Prot, dt. 12.01.2024, pasi me shkresën tuaj të datës 257/14 nuk na është dhënë informacioni i plotë dhe as në metodikën e kërkuar. Në këto kushte, lutemi përsa vijon:

- a. Cila ka qenë **sasia e nevojshme/ sasia e tenderuar/ sasia e administruar** në pavionet e QSUT për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023 për barnat:
 - a) Mabetheria;
 - b) Velcade;
 - c) Neupogen;

d) Endoksan;

b. Cila ka qenë sasia e nevojshme/ sasia e tenderuar/ sasia e administruar në pavionet e QSUT për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023 për barnat:

a) L'asparaginase;

b) Metratroxate 50 mg;

c) Dacarbasin

3.1 Me shkresën me Nr. 257/21 prot, datë 20.05.2024 Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza, ka kthyer përgjigje si më poshtë:

Në përgjigje të shkresës me Nr. Prot. OSUT Dt. 257/17 Dt. 07.05.2024 me lëndë: 'Kërkesë' ardhur nga Organizata Shqipëria Bëhet, ju informojmë se Drejtoria e Shërbimit Farmaceutik lidh kontrata duke u bazuar në kërkesat mujore të ardhura nga shërbimet, për barna për përdorim spitalor, si dhe duke u bazuar në gjendjen e tyre pranë depos së barnave dhe materialeve mjekësore.

Për sa i përket pikave të listuara nga ana juaj lidhur me sigurimin e barnave, kërkojmë të na vihet në dispozicion informacioni:

1. Cila ka qenë sasia e nevojshme, sasia e tenderuar, sasia e administruar ne pavionet e QSUT për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023 për barnat

- Mathera

- Velcade

- Neupogen

- Endoksan

2. Cila ka qene sasia e nevojshme, sasia e tenderuar, sasia e administruar ne pavionet e QSUT per vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023 për barnat

- L'asparaginase

- Methotrexate

- Dacarbasine

Përsa i përket pikave të mësipërme ju bëjmë me dije se si më poshtë:

1. Sasia e tenderuar nga MSHMS në cilësinë e OQB per barin Mabthera (Rituximab), 500 mg, dhe e përcjellë nëpërmjet marreveshjes kuadër për vitin 2020-2022 është 1450 flakon; për vitin 2022-2024 është 2000 flako. Sasia e administruar per vitin

2020 është 860 flakon; 883 flakon për vitin 2021; 552 flakon për vitin 2022; 920 flakon për vitin 2023

2. Sasia e tenderuar nga MSHMS në cilësinë e OQB për barin Mabthera (Rituximab) 100 mg, dhe e përcjellë nëpërmjet marrëveshjes kuadër për vitin 2020-2022 është 670 flakon; për vitin 2022-2024 është 1100 flakon. Sasia e administruar për vitin 2020 është 300 flakon; 431 flakon për vitin 2021; 271 flakon për vitin 2022; 428 flakon për vitin 2023.
3. Sasia e tenderuar nga MSHMS në cilësinë e OQB për barin Velcade (Bortezomib) 3,5 mg, dhe përcjellë nëpërmjet marrëveshjes kuadër për vitin 2020-2022 është 2000 flakon; për vitin 2022-2024 është 2000 flakon.
Sasia e administruar për vitin 2020 është 1017 flakon; 1522 flakon për vitin 2021; 1435 flakon për vitin 2022; 1493 flakon për vitin 2023.
4. Sasia e tenderuar nga MSHMS në cilësinë e OQB për barin Neupogen (Filgrastrim) 0,4mcg, dhe përcjellë nëpërmjet marrëveshjes kuadër për vitin 2020-2022 është 10300 flakon; për vitin 2022-2024 është 11000 flakon.
Sasia e administruar për vitin 2020 është 3426 flakon; 5436 flakon për vitin 2021; 4629 flakon për vitin 2022; 5979 flakon për vitin 2023.
5. Sasia e tenderuar nga MSHMS në cilësinë e OQB për barin Endoksan (Cyclophosphamid) 500 mg: dhe e përcjellë nëpërmjet marrëveshjes kuadër për vitin 2020-2022 është 14000 flakon; për vitin 2022-2024 është 19000 flakon.
Sasia e administruar për vitin 2020 është 6108 flakon; 8187 flakon për vitin 2021; 7529 flakon për vitin 2022; 6805 flakon për vitin 2023.
6. Për barin Methotrexate 50 mg sasia e tenderuar nga QSUNT për vitin 2020-2022 është 9000 flakon; sasia e tenderuar nga MSHMS për vitin 2022-2024 është 3600 flakon. Sasia e administruar për vitin 2020 është 230 flakon; 0 flakon për vitin 2021; 0 flakon për vitin 2022; 0 flakon për vitin 2023.
Nga shërbimet janë përdorur për dozat Methotrexate 500 mg; Methotrexate 10 mg/0.4 mg shiringë. Barna zëvendësohet të cilat kanë qene gjendje nëq depon qendrore.
7. Sasia e tenderuar nga MSHMS në cilësinë e OQB për barin Dacarbasine 100 mg: dhe e përcjellë nëpërmjet marrëveshjes kuadër për vitin 2020-2022 është 5310 flakon; për vitin 2022-2024 sasia e tenderuar nga QSUNT është 5310 flakon.
Sasia e administruar për vitin 2020 është 3216 flakon; 2662 flakon për vitin 2021; 1894 flakon për vitin 2022; 1760 flakon për vitin 2023.
8. Përsa i përket barit L'asparaginase prej vitit 2017 bari asparaginase nuk ka patur leje importi për këtë medikament për vitin 2020-2022 kanë ardhur donacion 250

flakon,; përgjatë vitit 2022-2024 është zevëndësuar nga (crissantaspase) i tenderuar nga QSUNT 250 flakon.

Sasia e administruar për vitin 2020 256 flakon; 52 flakon për vitin 2021; 0 flakon për vitin 2022; crissantaspase 69 flakon për vitin 2023.

- 4.1 Me shkresën me Nr. 7 prot, datë 12.01.2024 (administruar në QSU “Nënë Tereza” me nr. 257 prot, datë 18.01.2024) Organizata “Shqipëria bëhet” i ka kërkuar Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë informacion për sa më poshtë:

Sa është numri i pacientëve të regjistruar pranë QSUT me diagnozën Hemofili A dhe Hemofili B për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023?

Cila ka qenë sasia e faktorëve VIII dhe IX të përdorur nga QSUT për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023?

Cila ka qenë sasia e nevojshme për tu përdorur për pacientet me Hemofili A dhe Hemofili B të regjistruar pranë QSUT për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023?

- 5.1 Me shkresën me Nr. 257/16 prot, datë 31.01.2024 Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza, ka kthyer përgjigje si më poshtë:

- a. Numri i pacientëve të regjistruar pranë QSUT me diagnozën Hemofili A janë 174 adultë dhe 42 pacientë të moshës pediatrike;
- b. Sasia që mendohet të konsumohet përafërsisht nga qendra e hemofilisë për pacientët adultë është: Faktor VIII – 9,000,000 UI në vit; Faktor IX – 1,500,000 UI në vit; Sasia që mendohet të konsumohet përafërsisht nga qendra e hemofilisë për pacientët pediatrik është: Faktor VIII – 1,200,000 UI në vit; Faktor IX – 700,000 UI në vit;
- c. Në lidhje me sasinë e nevojshme të barnave që duhet të përdoret për pacientët me Hemofili A dhe Hemofili B për vitet 2020, 2021, 2022, 2023, nuk mund të bëjmë një ndarje në vite për shkak se pacientët të cilët kurohen me hemofili janë pacientë kronik, të cilët kurohen në vijimësi vijimësi dhe të paraqiten më shpesh pranë qendrës së hemofilisë, kryesisht cdo muaj.
- d. Sasia e barnave Faktor VIII dhe factor IX për trajtimin e diagnozës me Hemofili A dhe Hemofili B, sigurohet përmes donacioneve (QSUNT bashkëpunon me projekte të ndryshme me organizatat ndërkombëtare apo Qendra Spitalore) dhe përmes procedurave të prokurimit të cilat realizohen në QSUNT.

- 6.1 Në kuadër të punës së kësaj Lëvizje si edhe bazuar në parashikimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Neni 23, sipas të cilit na lind e drejta e informimit për veprimtarinë e organeve shtetërore, në këtë rast e drejta për tu informuar mbi veprimtarinë e Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza, kemi kërkuar informacion me shkresën Nr. 7 Prot, dt. 12.01.2024 ku kemi kërkuar sa vijon:

- a. Sa është numri i pacientëve të regjistruar pranë QSUT me diagnozën Hemofili A dhe Hemofili B për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023?
- b. Cila ka qenë sasia e faktorëve VIII dhe IX të përdorur nga QSUT për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023?
- c. Cila ka qenë sasia e nevojshme për tu përdorur për pacientet me Hemofili A dhe Hemofili B të regjistruar pranë QSUT për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023?

- 7.1 Nga përgjigja juaj me Nr. 257/16 Prot, dt. 31.01.2024, na rezulton që përgjigjet nuk janë të plota dhe sipas metodikës së kërkuar nga ana jonë. Në këto kushte lutemi për saktësimin e përgjigjes duke ndarë shifrat e pacientëve të sëmurë me Hemofili A dhe Hemofili B sipas viteve të kërkuara, ku përcaktohet qartë shifrat e pacientëve për secilin vit veçmas. Kjo na shërben për të parë edhe trendin e kësaj sëmundje.
- 8.1 QSUT nuk i ka kthyer përgjigje shkresës tonë që ka kërkuar informacion për informacionin e paqartë të ardhur me shkresën me Nr. 257/16 Prot, dt. 31.01.2024;
- 9.1 Me shkresën me Nr. 9/1 prot, datë 12.01.2024 (administruar në QSU “Nënë Tereza” me nr. 257/1 prot, datë 18.01.2024) Organizata “Shqipëria bëhet” i ka kërkuar Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë informacion për sa më poshtë:
- A ofrohet nga Spitali Universitar "Nënë Tereza" imunohistokimia? Nëse jo, prej sa kohësh nuk ofrohet dhe cila është arsyeja?
 - A ofrohet nga Spitali Universitar "Nënë Tereza" Trombohektomia? Nëse jo, prej sa kohësh nuk ofrohet dhe cila është arsyeja?
 - A ofrohet nga Spitali Universitar "Nënë Tereza" Dermatoskopia? Nëse jo, prej sa kohësh nuk ofrohet dhe cila është arsyeja?
- 10.1 Me shkresën me Nr. 257/13 prot, datë 31.01.2024 Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza, ka kthyer përgjigje si më poshtë:
- Në QSUNT ofrohet imunohistokimia në Shërbimin e Anatomisë Patologjike;
 - Për sa i përket kësaj pyetje sqarojmë se: Njësia e shërbimit neurovascular (STROKE/POST STROKE), pranë PAI Neuroshkencë, është funksionale dhe aktualisht shërbimi i trombolizës intravenoze për sëmundjet ishemike ofrohet nga kjo njësi. Trombektomia është procedurë e cila realizohet nëpërmjet paisjes mjekësore të llojit angiograf. Pranë QSU “Nënë Tereza”, PAI Neuroshkencë, paisja angiograf e disponuar, është funksionale, dhe shërben për diagnostikim dhe trajtim të pacientëve të QSUNT. **Por kjo aparaturë nuk është e përshtatshme për aplikimin e procedurës së trombektomisë.**
Nga MSHMS, janë marrë masat për të mundësuar furnizimin e QSUNT për paisje të llojit angiograf, bioplan, të përshtatshme për realizimin e ndërhyrjes së trombektomisë. Janë realizuar vetëm 5 procedura trombektomie në 2015 me asistencën e kolegëve neuroradiology francez dhe zvicerian të cilët na ndihuan dhe më bazën material. 2 nga procedurat rezultuan me sukses.
 - Për sa lidhet me pyetjen a ofrohet dermatoskopia ju informojmë se ndodhemi në kushtet e zëvendësimit të paisjeve difektoze, ku QSUNT ka porositur nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale aparaturën Dermatoskan.
- 11.1 Me shkresën me Nr. 47 prot, datë 03.05.2024 (administruar në QSU “Nënë Tereza” me nr. 257/18 prot, datë 07.05.2024 Organizata “Shqipëria bëhet” i ka kërkuar Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë informacion për sa më poshtë:
- Prej sa kohësh ofrohet imunohistokimia në QSUNT dhe cilat janë aparaturat që ofrojnë këtë shërbim?
Imunohistokimia është një teknikë e cila është kryer në Shërbimin e Anatomisë Patologjike në QSUT nga viti 2013, ndërkohë nga viti 2022 ofrohet nga subjektet koncesionare sipas kontratës PPP.

- b. Në lidhje me "Tromboektominë" vazhdojmë të mbetemi të paqartë nëse ajo ofrohet në spitalin QSUNT apo jo? Kjo pasi ju thoni që paisja është funksionale, por nuk është e përshtatshme për aplikimin e kësaj procedure. Cfarë masash janë ndërmarrë për të mundësuar këtë shërbim? A është ofruar ky shërbim pas vitit 2015? Nëse po, sa herë në vit është ofruar?

Sa më sipër kërkuar informacion ju bëjmë me dije se :

Shërbimi Neurovaskular (Stroke/Post Stroke) pranë PAI-t Neuroshkencë, është funksional dhe aktualisht shërbimi i trombolizës intravenoze për sëmundjet ishemike ofrohet nga kjo njësi shërbimi.

Trombektomia është procedurë e cila realizohet nëpërmjet pajisjes mjekësore të llojit angiograf.

Angiografi Monoplan pranë Njësisë së Shërbimit Neurovaskular (Stroke/ Post Stroke), pranë PAI-t Neuroshkencë është funksionale që prej vitit 2007, gjatë vitit 2023 në periudhën Janar - Gusht janë realizuar : 92 trajtime të rrugëve biliare ku futen drenazhe, stente dhe kontrole ,230 skopi televizive të sistemit kockor, 30 trajtime të hernieve diskale nëpërmjet infiltrimit, 6 tratime me infitrim transkraniale për neuralgjinë trigeminale, 1 embolizim të mëlcisë për një tumor malinj.

Por, kjo aparaturë, nuk është e përshtatshme për aplikimin e procedurës së trombektomisë. QSUNT ofron shërbimet sipas protokollit të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për trajtimin e pacientëve me patologji ishemi cerebrale.

Aktualisht ofrohet shërbimi i trombolizës intravenoze për sëmundjet ishemike cerebrale nga kjo njësi dhe shërben për trajtimin e pacientëve të QSUNT referuar protokollit të trajtimit, pranë Shërbimit të Neuroshkencës, aplikohet protokollit i miratuar, duke filluar nga pritja në urgjencë, diagnostikimi radiologjik, klasifikimi i pacientit nëse është kandidat për trombolizë apo jo, trajtimi i specializuar në qendrën Stroke, dhe me tej periudha rehabilituese.

Duke qene se aparatura e llojit angiograf që aktualisht ndodhet pranë PAI Neuroshkence, nuk është e përshtatshme për aplikimin e ndërhyrjes së trombektomisë, nga MShMS janë marrë masat për të mundësuar pajisjen e QSUNT për aparatit të llojit Angiograf Biplan, të përshatshme për realizimin e ndërhyrjes së trombektomisë.

Ju informoj se në QSUNT janë realizuar vetëm 5 (pesë) procedura trombektomie në vitin 2015 me asistencën e kolegeve neuroradiologe Francez dhe Zviceran te cilët na ndihmuan edhe me bazën materiale. Dy nga këto procedura rezultuan me sukses.

3. Përsa i takon përgjigjes tuaj mbi "Dermatoskopinë", ju thoni që jeni në kushtet e zëvendësimit të pajisjeve difektoze.

Referuar përgjigjes suaj kërkojmë informacion për sa më poshtë:

- A është bërë porosia?

“Pajisja e re e Dermatoskopisë është në proces prokurimi nga MSHMS. Sapo të përfundojë procesi, pajisja do të shkojë pranë Shërbimit të Dermatologjisë dhe do të rrisë cilësinë e shërbimit të ofruar ndaj pacientëve.”

- Cfarë procedure keni ndjekur?

Nuk kemi informacion mbi procedurën e prokurimit të ndjekur nga MSHMS.

- Prej cilës datë nuk ofrohet ky shërbim?

“Shërbimi nuk është ndërprerë totalisht pasi në shumë raste mjekët e Shërbimit të Dermatologjisë kanë vijuar të kryejë ekzaminimet e tyre me Dermatoskop manual, sidomos në rastet emergente kur nga ana klinike ka qene shumë e nevojshme vendosja e diagnozës me anë të kësaj pajisjeje.”

12.1 Me shkresën më Nr. 908/4 Prot, datë 06.03.2020 me lëndë “Mbi planifikimin e nevojave 24 mujore (2020-2021 të QSU “Nënë Tereza”, Drejtori i Përgjithshëm Z. Enkelejdi Joti i kthen përgjigje Ministrisë së Shëndetësisë si më poshtë:

“Theksojmë se për të qendruar brenda limiteve buxhetore dhe referuar listës të re të cmimeve një pjesë e sasive të paraqitura janë të reduktuara krahasuar me një vit më parë. Bazuar në shtimin e numrit të pacientëve të shtruar pranë QSUT (me një tendencë rreth 10% cdo vit, ky planifikim do të sjell pamundësi të plotësimi të nevojave për të gjithë pacientët që marrin shërbim pranë qendrës sonë spitalore”.

12.2 Me shkresën më Nr. 908/2 Prot, datë 03.03.2020 me lëndë “Në vijim të planifikimit të nevojave 24 mujore (2020-2021) të QSU “Nënë Tereza” Tiranë”, Drejtori i Përgjithshëm Z. Enkelejdi Joti i kthen përgjigje Ministrisë së Shëndetësisë si më poshtë:

“Për sa i përket medikamenteve koagulant Faktor VIII referuar shkresës tuaj me nr. 3737/3 prot, datë 18.11.2019 e administruar në QSU “Nënë Tereza” me nr. 26/13 prot, datë 20.11.2019 “Mbi vendimin nr. 142, datë 10.10.2019 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për subjektin K.M” ju bëjmë me dije se parashikimi real vjetor (për 12 muaj) referuar komunikimeve me shërbimet pranë QSU “Nënë Tereza” Tiranë, është 28 milion UI (për vitin 2020) + 36 milion UI (për vitin 2021 duke përllogaritur ndryshimin e faktorëve që ndikojnë drejtpërdrejtë në sasinë e parashikuar), ndërsa referuar rishikimit të planifikimeve sipas përcaktimeve të VKM nr. 42, datë 22.01.2020 “Për financimin e shërbimeve spitalore shëndetësorë nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2020”. Sasia e planifikuar për vitin 2020 është 4,250,000 UI Faktor VIII, ndërsa për vitin 2021 është 4,625,000 UI Faktor VIII, kjo duke mos përfshirë sasinë e mundëshme që mund të sigurohet nga donacion të ndryshme për të cilat QSU “Nënë Tereza” investohet vazhdimisht.

12.3 Me email-in e datës 03.06.2020, ora 1.29 PM të nisur nga info MOH (Ministry of Health), drejtuar QSUT Nënë Tereza me adresë QSUT@shendetesia.gov.al dhe cc mirelarexhepi@gmail.com, Ministria e Shëndetësisë I kërkon QSU "Nënë Tereza" si më poshtë:

"Për këtë arsye dërgoni planifikimin duke përshtatur sasitë e cdo bari referuar edhe cmimeve njësi të vitit 2020 të grupit të punës së MSHMS duke qëndruar edhe brenda tavaneve buxhetore që ju keni të akorduar relativisht për cdo vit".

- 12.4 Të gjitha indikacionet që rezultojnë nga shkresat e sipërcituara shtyjnë drejt konkluzionit se ka mangësi në furnizimin me ilace për kategoritë e sëmundjeve të rënda si dhe mosfunksionim të paisjeve mjekësore për një kohë të gjatë.
- 12.5 Rezulton se institucionet shëndetësore kanë pasur dijeni për mangësitë e ilaceve dhe paisjeve mjekësore dhe nuk kanë marrë masa për të korigjuar këto mangësi të cilat kanë dëmtuar shëndetin ose kanë shkaktuar humbjen e jetës së qytetarëve.
- 13.1 Sa më sipër, sot i drejtohem prokurorisë më këtë kallëzim penal ndaj institucioneve të cilat kanë pasur dijeni në lidhje me mungesën e furnizimit me ilace si dhe mosfunksionimin e paisjeve mjekësore që shërbejnë për trajtimin e sëmundjeve të rënda e që kanë shkaktuar mostrajtimin në kohë për pacientët duke shkaktuar dëmtimin e shëndetit apo humbjen e jetës së tyre dhe konkretisht për veprat penale të "Shpërdorimit të Detyrës", "Neglizhenca në trajtimin mjekësor", "Vrasje me dashje", parashikuar nga nenet 248, 96 dhe 76 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

II. LIGJI I APLIKUESHËM

- 2.1 Kodi i procedurës Penale, në nenet e tij 280 dhe 283 parashikon se: "*Neni 280 "Marrja dijeni për veprën penale": Prokurori dhe policia marrin dijeni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët..."*
Neni 283: "Çdo person që ka marrë dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm..."
- 2.2 Neni 76 i Kodit Penal "Vrasje me dashje";
- 2.3 Neni 96 i Kodit Penal "Neglizhenca në trajtimin mjekësor";
- 2.4. Neni 248 i Kodit Penal, "Shpërdorimi i detyrës": "*Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet."*
- 2.5 Ligji nr.10 107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë";
- 2.6 Pikat 1, 2, 3 dhe 4/a, të VKM nr. 135, datë 20.2.2013, "Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime", i ndryshuar,
- 2.7 Neni 5, pika 2, germat "a" dhe "b", nenin, 10, pika 1, germat "a", "b", dhe "c", nenin 12, pika 1, germa "a", të Ligjit nr. 10 383, dt. 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- 2.8 Pika 1, e VKM nr. 307, dt. 21.05.2014, "Për regjistrimin dhe identifikimin e personave

- 2.9 të siguruar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor”, i ndryshuar;
Neni 50, i Ligjit nr. 9106, dt. 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 1, neni 2/1 dhe neni 3, germat “a” dhe “ç”.

III. ANALIZA JURIDIKE E FAKTEVE

3.1 Në lidhje me veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë:

Objekt i veprës penale janë mardhëniet juridike të vendosura me ligj, ose në aktet nënligjore për të siguruar veprimtarinë normale të aparatit shtetëror si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve ose të shtetit të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive kjo vepër kryhet përmes veprimeve aktive ose mosveprimeve që përbëjnë mospërbushje të detyrës së përcaktuar nga ligji. Veprimi aktiv karakterizohet nga fakti se ai kryhet nga punonjësi i ngarkuar nga ligji me funksion publik në kundërshtim me përcaktimet ligjore.

Subjekt i kësaj vepre penale është i posacëm, cdo punonjës i ngarkuar me funksion publik.

Nga ana subjektive kjo vepër kryhet me dashje të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë ndaj veprimeve ose mosveprimeve dhe me pakujdesi ndaj pasojave të ardhura.

Neni 2, i Ligjit nr.10 107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, përcakton se:

“Kujdesi shëndetësor udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- a) e drejta për kujdes shëndetësor është një e drejtë themelore e individit;*
- b) garantimi i të drejtave të barabarta në kujdesin shëndetësor, bazuar në mosdiskriminim;*
- c) sistemi i kujdesit shëndetësor funksionon mbështetur në efikasitetin dhe cilësinë e shërbimit, duke garantuar sigurinë e pacientit dhe paanësinë;*
- ç) pjesëmarrja e aktorëve të ndryshëm, pacientëve, konsumatorëve dhe qytetarëve;*
- d) llogaridhënia ndaj qytetarëve.”*

Neni 3, pikat 1, 2, 3, 6, 7 dhe 11, të Ligjit nr.10 107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, përcakton se:

“Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- 1. “Autoritetet shëndetësore” janë Ministria e Shëndetësisë dhe strukturat rajonale në varësi të saj.*
- 2. “Ofruesit e kujdesit shëndetësor” janë personat publikë ose privatë, fizikë ose juridikë, si dhe organizatat jofitimprurëse, të cilët janë të regjistruar nga Ministria e Shëndetësisë, për të siguruar kujdes shëndetësor në përputhje me këtë ligj.*
- 3. “Kujdesi shëndetësor” është tërësia e masave dhe veprimtarive të ndërmarra nga*

institucionet e kujdesit shëndetësor, punonjës shëndetësorë dhe shtetas, me qëllim përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme fizike, mendore dhe sociale të shtetasve.

6. "Shërbimet e kujdesit shëndetësor" janë ndërhyrjet mjekësore për të rritur mbrojtjen dhe trajtimin shëndetësor, nëpërmjet parandalimit, diagnostikimit, masave kurative dhe rehabilituese, të siguruara nga ana e ofruesve të regjistruar të kujdesit shëndetësor.

7. "Sistemi i kujdesit shëndetësor" është organizimi, financimi dhe shpërndarja e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, ku përfshihen: promovimi dhe parandalimi shëndetësor; shërbimi diagnostikues, terapeutik dhe rehabilitues; politikat e kujdesit shëndetësor, ligjet, rregulloret dhe standardet për zbatimin e politikave dhe bashkëveprimet të qeverisë qendrore, vendore dhe ofruesve publikë ose privatë të shërbimeve shëndetësore.

11. "Urgjenca mjekësore" është një dëmtim ose sëmundje akute dhe që përbën një rrezik të menjëhershëm të jetës së personit apo të shëndetit të mëtejshëm të tij."

Neni 4, pikat 3 dhe 4 të Ligjit nr.10 107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", përcakton se:

"Përgjegjësitë e shtetit

3. Ministri i Shëndetësisë drejton politikën, organizimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të kujdesit shëndetësor.

4. Ministria e Shëndetësisë përgatit strategjinë e sistemit të kujdesit shëndetësor, e cila përfshin politika dhe programe përkatëse të shëndetësisë dhe protokolle kombëtare të trajtimit."

Neni 23, pika 1 e Ligjit nr.10 107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", përcakton se:

"Mbikëqyrja e institucioneve të kujdesit shëndetësor

1. Ministria e Shëndetësisë mbikëqyr zbatimin e rregullave dhe të standardeve në institucionet e kujdesit shëndetësor."

Neni 24, pika 1 e Ligjit nr.10 107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", përcakton se:

"Mbikëqyrja e brendshme

1. Mbikëqyrja e brendshme profesionale organizohet dhe drejtohet nga drejtorët e institucioneve të kujdesit shëndetësor, në zbatim të rregullave të brendshme operative, bazuar në standardet e përcaktuara nga Ministri i Shëndetësisë.

2. Mbikëqyrja e institucionit ka si objekt:

a) zbatimin e ligjit dhe të akteve nënligjore;

b) zbatimin e standardeve profesionale dhe të cilësisë.

3. Të gjithë librat, regjistrat dhe të dhënat e tjera, në formë elektronike ose në letër, duhet të vihen në dispozicion të inspektorit të autorizuar, me kërkesën e tij. Pengimi apo ndalimi i veprimtarive të inspektorit të autorizuar, nga cildo zyrtar apo punonjës i institucionit të kujdesit shëndetësor, përbën shkelje."

Pikat 1, 2, 3 dhe 4/a, të VKM nr. 135, datë 20.2.2013, "Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime", i ndryshuar, përcakton se:

"1. Lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të spitaleve publike në varësi të saj, për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore.

2. Ministria e Shëndetësisë të prokurojë fondin limit, të llogaritur si shumë e fondeve buxhetore, të miratuar për çdo spital, për secilin nga artikujt.

3. Autoritetet kontraktore, institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, brenda muajit shkurt, të dërgojnë në Ministrinë e Shëndetësisë, si organi qendror blerës, të dhënat, teknike e sasiore dhe fondin përkatës për çdo artikull që prokurohet.

4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për nevojat spitalore, përfshirë procedurat e prokurimit me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit;"

Neni 5, pika 2, gjerat "a" dhe "b", të Ligjit nr. 10 383, dt. 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcakton se:

"2. Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor mbulon, gjithashtu, kategoritë e mëposhtme të personave ekonomikisht joaktivë, pagesa e kontributeve të të cilëve financohet nga Buxheti i Shtetit ose burime të tjera të përcaktuara me ligj:

a) personat që përfitojnë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;

b) personat që përfitojnë ndihmë ekonomike ose pagesën për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin përkatës;"

Në nenin, 10, pika 1, gjerat "a", "b", dhe "c", të këtij ligji, përcaktohet se:

"1. Sigurimi i detyrueshëm financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen:

a) vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor publik dhe në spitale të publike;

b) vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në dhënës privat të kujdesit parësor dhe spitale private;

c) barnat, produktet dhe trajtimet mjekësore nga dhënës të kontraktuar shërbimesh shëndetësore."

Në nenin 12, pika 1, germa "a", të këtij ligji sanksionohet se:

“1. Fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor nuk financon shërbime të kujdesit shëndetësor ndaj personave të pasiguruar, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

a) shërbimi i urgjencës mjekësore;”

Pika 1, e VKM nr. 307, dt. 21.05.2014, “Për regjistrimin dhe identifikimin e personave të sigurve nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor”, i ndryshuar, ku thuhet se:

“1. Të sigurve në skemën e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor quhen personat ekonomikisht aktivë, me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, që paguajnë kontributin e detyrueshëm të sigurimit shëndetësor, personat ekonomikisht joaktivë, pagesa e kontributeve të të cilëve financohet nga buxheti i shtetit ose burime të tjera, të përcaktuara me ligj, si dhe personat e sigurve në mënyrë vullnetare.”

Sa më sipër, rezulton se personat e kallëzuar janë subjekte të ngarkuar nga ligji me proceset e menaxhimit dhe sigurimit të barnave mjekësore dhe paisjeve teknike mjekësore pranë QSU “Nënë Tereza”.

Në lidhje me përgjegjësinë penale të shtetasve Ilir Beqja, Ogerta Manastirliu dhe Albana Kociu në cilësinë e Ministrit të Shëndetësisë sipas nenit 4, pikat 3 dhe 4 të Ligjit nr.10 107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, përcakton se:

“Përgjegjësitë e shtetit

3. Ministri i Shëndetësisë drejton politikën, organizimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të kujdesit shëndetësor.

4. Ministria e Shëndetësisë përgatit strategjinë e sistemit të kujdesit shëndetësor, e cila përfshin politika dhe programe përkatëse të shëndetësisë dhe protokolle kombëtare të trajtimit.”

Në lidhje me përgjegjësinë penale të shtetasit Ilir Beqja:

Rezulton se shtetasi Ilir Beqja nuk ka përmbushur përcaktimet ligjore të nenit 4, pika 3 dhe 4, nenit 23 pika 1, nenit 24 pika 1 të ligjit nr.10 107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” pasi nuk ka bërë mbikëqyrjen e sistemit shëndetësor e nuk ka marrë masa për plotësimin për ilacet që rezultojnë se mungojnë dhe paisjet e dëmtuara të provuara sipas shkresave të administruara nga QSUT dhe konkretisht paisjen e QSU “Nënë Tereza” për procedurën e tromboektomisë si dhe ilacet për sëmundjet e onkologjisë dhe faktorët VIII dhe IX për pacientët me hemofili.

Rezulton se nga ana e Minsitrisë së Shëndetësisë nuk ka qenë miratuar një protokoll për trajtimin profilaktik të të sëmurëve me Hemofili. Kjo mangësi ka sjellë trajtimin e tyre vetëm në raste urgjencash e për pasojë ka çuar në invalidizimin e tyre, infektimin e tyre me Hepatit C dhe humbjen e jetës nga episode hemoragjike.

Në lidhje me përgjegjësinë penale të shtetasit Ogerta Manastirliu:

Rezulton se shtetasi Ilir Beqja nuk ka përmbushur përcaktimet ligjore të nenit 4, pika 3 dhe 4, nenit 23 pika 1, nenit 24 pika 1 të ligjit nr.10 107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" pasi nuk ka bërë mbikqyrjen e sistemit shëndetësor e nuk ka marrë masa për plotësimin për ilaçet që rezultojnë se mungojnë dhe paisjet e dëmtuara të provuara sipas shkresave të administruara nga QSUT dhe konkretisht paisjen e QSU "Nënë Tereza" për procedurën e tromboektomisë si dhe ilaçet për sëmundjet e onkologjisë dhe faktorët VIII dhe IX për pacientët me hemofili.

Rezulton se nga ana e Minsitrisë së Shëndetësisë nuk ka qenë miratuar një protokoll për trajtimin profilaktik të të sëmurëve me Hemofili. Kjo mangësi ka sjellë trajtimin e tyre vetëm në raste urgjencash e për pasojë ka cuar në invalidizimin e tyre, infektimin e tyre me Hepatit C dhe humbjen e jetës nga episode hemoragjike.

Në lidhje me përgjegjësinë penale të shtetasit Albana Kociu:

Rezulton se shtetasi Ilir Beqja nuk ka përmbushur përcaktimet ligjore të nenit 4, pika 3 dhe 4, nenit 23 pika 1, nenit 24 pika 1 të ligjit nr.10 107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" pasi nuk ka bërë mbikqyrjen e sistemit shëndetësor e nuk ka marrë masa për plotësimin për ilaçet që rezultojnë se mungojnë dhe paisjet e dëmtuara të provuara sipas shkresave të administruara nga QSUT dhe konkretisht paisjen e QSU "Nënë Tereza" për procedurën e tromboektomisë si dhe ilaçet për sëmundjet e onkologjisë dhe faktorët VIII dhe IX për pacientët me hemofili.

Rezulton se nga ana e Minsitrisë së Shëndetësisë nuk ka qenë miratuar një protokoll për trajtimin profilaktik të të sëmurëve me Hemofili. Kjo mangësi ka sjellë trajtimin e tyre vetëm në raste urgjencash e për pasojë ka cuar në invalidizimin e tyre, infektimin e tyre me Hepatit C dhe humbjen e jetës nga episode hemoragjike.

Nga organi prokurorisë kërkohet që për vërtetimin e kësaj vepre penale të hetohet në drejtim të sa më poshtë:

Në lidhje me mungesën e faktorëve VIII dhe IX për pacientët me hemofili:

1. Të administrohen kartelat mjekësore të të gjithë pacientëve të diagnostikuar me hemofili të tipit A dhe B prej vitit 2015 e në vazhdim;
2. Të verifikohet sa prej këtyre shtetasve janë infektuar me hepatit C nga casti i diagnostikimit me hemofili e në vazhdim;
3. Të verifikohet për secilin prej pacientëve të listuar pranë QSUT me diagnozën hemofili e tipit A dhe B për sasinë e faktorëve VIII dhe IX që u është vendosur në dispozicion prej vitit 2015 e në vazhdim;
4. Të verifikohet për çdo pacient sa ka qenë sasia e rekomanduar nga mjeku hematolog për mjekim me faktor VIII dhe IX për periudhën 2015 e në vazhdim;
5. Cila ka qenë sasia e barnave faktor VIII dhe IX për trajtimin e diagnozes Hemofili A dhe Hemofili B e kerkuar nga Qsut per vitet 2015-2023?

6. Cila ka qenë sasia e barnave faktor VIII dhe IX per trajtimin e diagnozes Hemofili A dhe Hemofili B e tenderuar nga shteti shqiptar per vitet 2015-2023?
7. Cila ka qenë sasia e barnave faktor VIII dhe IX per trajtimin e diagnozes Hemofili A dhe Hemofili B e administruar nga Qsut per vitet 2015-2023?

Në lidhje me mungesën e Metratroxate 50mg; L-Asparaginase; Mabetheria; Velcade; Neupogen; Endoksan; Dacarbasin, Gemcitabin:

1. Të administrohen praktikat e tenderimit të këtyre ilaceve për vitet 2015 e në vazhdim;
2. Të administrohen kërkesat e QSUNT për këto ilace prej vitit 2015 e në vazhdim;
3. Të administrohet dokumentacioni i pranimit në farmacinë e QSUNT të këtyre ilaceve për vitet 2015 e në vazhdim;
4. Të administrohen kartelat mjekësore të pacientëve të shtruar pranë QSUNT ne pavionet e onkologjië, onkologjisë pediatrike dhe hematologjisë dhe të verifikohet sasia e ilaceve të përdorura për këta pacient duke u krahasuar me sasinë që është tërhequr për ata nga farmacia spitalore;

Në lidhje me veprën penale të “Vrasje me dashje” të kryer në bashkëpunim të parashikuar nga nenet 25 dh 76 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë:

Objekt i veprës penale janë mardhëniet juridike të vendosura me ligj, ose në aktet nënligjore për të siguruar mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së shtetasve të mbrojtura posacërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive krimi i vrasjes karakterizohet nga veprime ose mosveprime të kundërligjshme.

Subjekt i kësaj vepre penale mund të jetë cdo person që ka mbushur moshën me ligj për përgjegjësi penale 14 vjec dhe është i përgjegjshëm.

Nga ana subjektive kjo vepër kryhet me dashje të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë pa paramendim.

Në lidhje me veprën penale të “Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër” të kryer në bashkëpunim të parashikuar nga nenet 25 dh 77 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë:

Objekt i veprës penale janë mardhëniet juridike të vendosura me ligj, për të siguruar jetën e njeriut, të sanksionuara në Kushtetutë.

Nga ana objektive krimi i vrasjes me dashje kryhet duke paraprirë, shoqëruar, fshehur ose pasuar një krim tjetër.

Subjekt i kësaj vepre penale mund të jetë cdo person që ka mbushur moshën me ligj për përgjegjësi penale 14 vjec dhe është i përgjegjshëm.

Nga ana subjektive kjo vepër kryhet me dashje të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë.

Me shkresën më Nr. 908/4 Prot, datë 06.03.2020 me lëndë “Mbi planifikimin e nevojave 24 mujore (2020-2021 të QSU “Nënë Tereza”, Drejtori i Përgjithshëm Z. Enkelejdi Joti i kthen përgjigje Ministrisë së Shëndetësisë si më poshtë:

“Theksojmë se për të qendruar brenda limiteve buxhetore dhe referuar listës të re të cmimeve një pjesë e sasive të paraqitura janë të reduktuara krahasuar me një vit më parë. Bazuar në shtimin e numrit të pacientëve të shtruar pranë QSUT (me një tendencë rreth 10% cdo vit, ky planifikim do të sjell pamundësi të plotësimi të nevojave për të gjithë pacientët që marrin shërbim pranë qendrës sonë spitalore”.

Me shkresën më Nr. 908/2 Prot, datë 03.03.2020 me lëndë “Nëvijim të planifikimit të nevojave 24 mujore (2020-2021) të QSU “Nënë Tereza” Tiranë”, Drejtori i Përgjithshëm Z. Enkelejdi Joti i kthen përgjigje Ministrisë së Shëndetësisë si më poshtë:

“Për sa i përket medikamenteve koagulant Faktor VIII referuar shkresës tuaj me nr. 3737/3 prot, datë 18.11.2019 e administruar në QSU “Nënë Tereza” me nr. 26/13 prot, datë 20.11.2019 “Mbi vendimin nr. 142, datë 10.10.2019 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për subjektin K.M” ju bëjmë me dije se parashikimi real vjetor (për 12 muaj) referuar komunikimeve me shërbimet pranë QSU “Nënë Tereza” Tiranë, është 28 milion UI (për vitin 2020) + 36 milion UI (për vitin 2021 duke përllogaritur ndryshimin e faktorëve që ndikojnë drejtpërdrejtë në sasinë e parashikuar), ndërsa referuar rishikimit të planifikimeve sipas përcaktimeve të VKM nr. 42, datë 22.01.2020 “Për financimin e shërbimeve spitalore shëndetësorë nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2020”. Sasia e planifikuar për vitin 2020 është 4,250,000 UI Faktor VIII, ndërsa për vitin 2021 është 4,625,000 UI Faktor VIII, kjo duke mos përfshirë sasinë e mundëshme që mund të sigurohet nga donacion të ndryshme për të cilat QSU “Nënë Tereza” investohet vazhdimisht.

Me email-in e datës 03.06.2020, ora 1.29 PM të nisur nga info MOH (Ministry of Health), drejtuar QSUT Nënë Tereza me adresë QSUT@shendetesia.gov.al dhe cc mirelarexhepi@gmail.com, Ministria e Shëndetësisë i kërkon QSU “Nënë Tereza” si më poshtë:

“Për këtë arsye dërgoni planifikimin duke përshtatur sasinë e cdo bari referuar edhe cmimeve njësi të vitit 2020 të grupit të punës së MSHMS duke qëndruar edhe brenda tavaneve buxhetore që ju keni të akorduar relativisht për cdo vit”.

Sa më sipër, rezulton se shtetasit Ilir Beqja, Ogerta Manastirliu, Albana Kociu, Enkelejdi Joti, Albana Fico kanë pasur dijeni për sasinë e limituar të ilaceve pasi nuk janë blerë aq sa keni nevojë e pacientëve, por aq sa mundësohej nga tavanit buxhetor.

Për verifikimin e kësaj veprë të rëndë penale kërkohet nga organi i prokurorisë sa më poshtë:

1. Të administrohen kartelat mjekësore të QSUNT për pavionet e onkologjisë, onkologjisë pediatrike dhe hematologjisë për vitet 2015 e në vazhdim për të gjithë pacientët që kanë ndërruar jetë;
2. Të verifikohen kartelat mjekësore të pacientëve që kanë ndërruar jetë duke verifikuar a u është bërë trajtimi mjekësor sipas protokolleve të miratuara në lidhje me llojin dhe sasinë e medikamenteve të nevojshme;

Në lidhje me mosfunksionimin apo mungesën e aparaturave mjekësore:

1. Të verifikohet prej vitit 2015 e në vazhdim për çfarë periudhash nuk është ofruar shërbimi i imunohistokimisë pranë QSUT-së?
2. Sa ka qënë numri i pacientëve që se kanë marrë këtë shërbim?
3. Të verifikohet prej vitit 2015 e në vazhdim çfarë periudhash nuk është ofruar shërbimi i dermatoskopisë pranë QSUT-së?
4. Të verifikohet pranë QSUNT, pavioni onkologjikut si është administruar aparatura e kobaltit dhe a janë përmbushur detyrimet ligjore për mbrojtjen nga rrezatimi?
5. Të kryhet pranë paisjes së kobaltit një akt ekspertim teknik për të vërtetuar nëse ka rrezatim radio aktiv tej normave të lejuara? Nëse po nga se është shkaktuar?

I nderuar Z. Prokuror,

Me besimin të shteti ligjor në si organizatë që kemi si objekt të veprimtarisë tonë shtetin e së drejtës bazuar dhe në nevojën e shoqërisë sonë për të mbrojtur shëndetin dhe jetën ju drejtohem për vendosjen e përgjegjësve përpara ligjit. Ju kujtojmë se si rezultat i veprimeve dhe mosveprimeve të këtyre shtetasve është cënuar besimi i publikut në institucionet shëndetësore të vendit, si dhe është cënuar drejtpërdrejtë shëndeti dhe jeta e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë.

Jemi besim plotë se ju do procedoni sipas ligjit duke i dhënë zgjidhje çështjes në një kohë të shpejtë.

IV. KËRKESAT PËRFUNDIMTARE

Përfundimisht, bazuar në sa më sipër kërkohet:

Regjistrimin e procedimit penal për veprat penale të "Shpërdorimit të Detyrës", "Vrasje

me dashje”, “Neglizhenca në trajtimin mjekësor” të kryera në bashkëpunim të parashikuara nga neni 76, 96, 248 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.;

Bashkangjitur .

1. Shkresa me Nr. 257/14 Prot QSUT, datë 31.01.2024 me lëndë “kthim përgjigje” nga Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza.
2. Shkresa me Nr. 257/21 Prot QSUT, datë 20.05.2024 me lëndë “kthim përgjigje” nga Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza.
3. Shkresa me Nr. 257/20 Prot QSUT, datë 20.05.2024 me lëndë “kthim përgjigje” nga Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza.
4. Shkresa me Nr. 257/16 Prot QSUT, datë 31.01.2024 me lëndë “kthim përgjigje” nga Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza.
5. Shkresa me Nr. 257/13 prot, datë 31.01.2024 e Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza.
6. Shkresa me Nr. 908/4 Prot, datë 06.03.2020 me lëndë “Mbi planifikimin e nevojave 24 mujore (2020-2021 të QSU “Nënë Tereza”, Drejtori i Përgjithshëm Z. Enkelejdi Joti i kthen përgjigje Ministrisë së Shëndetësisë.
7. Shkresa me Nr. 908/2 Prot, datë 03.03.2020 me lëndë “Në vijim të planifikimit të nevojave 24 mujore (2020-2021) të QSU “Nënë Tereza” Tiranë”, Drejtori i Përgjithshëm Z. Enkelejdi Joti i kthen përgjigje Ministrisë së Shëndetësisë.
8. Email datës 03.06.2020, ora 1.29 PM të nisur nga info MOH (Ministry of Health), drejtuar QSUT Nënë Tereza me adresë QSUT@shendetesia.gov.al dhe cc mirelarexhepi@gmail.com, Ministria e Shëndetësisë i kërkon QSU “Nënë Tereza” informacion.
9. Vendim Nr. 17, datë 05.02.2019 me nr. 179 prot i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
10. Raprotet e Kontrollit të Lartë të Shtetit për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” për vitet 2015 deri 2023.

Kallëzues

Organizata “Shqipëria bëhet”
përfaqësuar nga
Drejtori Ekzekutiv Adriatik Lapaj